

VENDIM
Nr. 96, datë 27.7.2012

**PËR DHËNIE LICENCE SUBJEKTIT PERSON FIZIK ARBEN MERTIRI PËR TELEVISIONIN
PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR ARTEN”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabllo”, miratuar me vendimin nr. 221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit person fizik Arben Mertiri për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. T’i japë licencë, subjektit person fizik Arben Mertiri, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV kabllor Arten”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunat Bubullimë dhe Gradishtë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen: struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati